



SHTOJCA:

Amandamenti i dispozitave të Kodit të Standardeve Elektrike

Neni 3.2.1.4:

Aktualisht: Deri më [1 Janar 2012], aty ku qarku ka ekzistuar para [1 Korrik 2006] siguron kyçjen me një nënstacion shpërndarës ose një nënstacion të një konsumatori të madh, i cili gjithashtu ka ekzistuar para datës [1 Korrik 2006], nivelet e tensionit do të jetë e detyrueshme të jenë brenda kufijve normal operues nëse seria e plotë e ndërruesit të pozitës që ka ekzistuar atëherë në transformatorin shpërndarës ose transformatorin e konsumatorit mund të kishte mbajtur tensionin nominal $\pm [10]\%$ në anën e ulët të tensionit të transformatorit që ka ekzistuar atëherë dhe ka operuar brenda ngarkesës të tij nominale të deklaruar.

Propozimi : Në të gjitha qarqet furnizuese të nënstacioneve shpërndarëse dhe të konsumatorëve të mëdhenj niveli i tensionit në anën primare (TL) dhe sekondare (TU) duhet të mbahet në kufijtë normal të operimit në pajtueshmëri me kërkesat që dalin nga Kodi i Rrjetit, duke shfrytëzuar rregullatorët e tensionit me mundësi të rregullimit në brezin $\pm 10\%$ në anën e tensionit të ulët.

Neni 4.2.1.2:

Aktualisht: Sipas procedurave të UCTE-së për sistemet e transmisionit të interkonektuara sinkrone gjatë kushteve normale të operimit, kufijtë e devijimit nga ajo e frekuencës nominale do të jetë $\pm [800]$ mHz. Nëse frekuenca e sistemit bie në [49.2] Hz, OSTT mund të bëjë reduktime të ngarkesës për të kthyer frekuencën e sistemit. Nëse frekuenca bie në [49] Hz, OSTT do të bëjë reduktime të ngarkesës në pajtim me dispozitat e doracakut operativ të UCTE-së.

Propozimi: Sipas procedurave të ENTSO-E-së për sistemet e transmisionit të interkonektuara sinkrone gjatë kushteve normale të operimit, kufijtë e devijimit nga ajo e frekuencës nominale do të jenë ± 800 mHz. Nëse frekuenca bie në 49 Hz, OST do të bëjë reduktime të ngarkesës në pajtim me dispozitat e Doracakut të Operimit të ENTSO-E-së.